



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenas/Gllogoc
Kuvendi i Komunës



02 Nr.-060/01-18587 dt. 16/04/2024

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Drenasit z.Milaim Hajdari, me dt. 23.04.2024 (E martë) duke filluar në ora 10:00, në sallën e Bordit të Drejtorëve të Komunës.

THËRRET
Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 20.03.2024.
2. Raporti Financiar Janar-Mars 2024.
3. Propozim vendim për formimin e komisionit për plotësim ndryshimin e nenit 85 të statutit të Komunës së Drenasit.
4. Propozim vendim për aprovimin Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr Hafir Shala” për Komunën e Gllogocit.
5. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 25 vite të pronës komunale të Komunës së Drenasit Ministrisë së Punëve të Brendshme – Policisë së Kosovës, për ndërtimin e nënstacionit Policor në zonën kadastrale Komoran të Komunës së Drenasit.
6. Propozim vendim Për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Gllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vite).
7. Të ndryshme.

Drenas, 16.04.2024



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



01 Nr. 060/04-18586 dt. 16/04/ 2024

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. **20.03.2024**, ora **10:00**

Mbledhjen e kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Florentina Elezi-Veliu (VV) si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend Dite:

1. **Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 22.02.2024.**
2. **Propozim vendim për plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës së Drenasit lidhur me emërtimin kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.**
3. **Propozim vendim për plotësim ndryshim të vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**
4. **Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 25 vite të pronës komunale të Komunës së Drenasit Ministrisë së Punëve të Brendshme – Policisë së Kosovës, për ndërtimin e nënstacionit Policor në zonën kadastrale Komoran të Komunës së Drenasit.**
5. **Raporti përfundimtar për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2022.**
6. **Të ndryshme.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- listen preliminare të pronav do ta qojm, ne e kemi diskutu këtu, e kom tërhjek prej seance, atë ditë nuk arriti me hy na e qojm si pikë të rendit të ditës votohet për ose kundër nuk e kemi asnjëlloj shqetësimi sot nuk kam nevoj me parashtru se nuk ka as një lloj ndryshimi prej asaj që ka qenë

Nexhmedin Gruda- e kemi edhe një propozim vendim për vazhdimin e afatit për zbatimin e planit për vlersimin e rezikut plani ka qen deri në vitn 2021-2023 deri në hartimin e planit të ri

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- ky document na duhet me pas që mos me kriju atë zbrazsin sepse edhe ne grand te performances eshte kriter na duhet me vazhdu afatin deri ta hartojm planin e ri

Nexhmedin Gruda- ne jemi duke punuar për planin e ri mirëpo për momentin me AME jemi atje, ata janë duke e bër rishqyrtimin e ti edhe një herë sepse duhet në kordinim me ata deri sa të na vjen raporti i tyre ne nuk mundemi me prezantu planin e ri, për këtë arsye na duhet me vazhdu me këtë plan për me dit a kem me plotësu diqka edhe në vitin 2024

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- plani I integritetit bëhet në kuadër të AME-së në bashkpunim me zjarrëfiksat

Arbër Halilaj- si sygjerrim ose propozim që në seanë ose në pikën të ndryshme dikush të raportoj rreth asaj që e kemi pas për këtë rastin me “Parkun e Biznesit” që Kryetari I Komunës me të drejt e ka cilësu si katastrof ekologjike, cilat kan qenë veprime bashkpunimi nivelit qendror me komunën ton sepse ka qen e përmasave tilla që kërkon edhe intervenimin e nivelit qendror edhe duke e pas parasysh ndikimin e kësaj dukurie në ambient, lirimin e substancave, kointaminimin e ambientit jetësor, domethën një lloj informimi të asambles?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- besoj deri në ditën e mbledhjes së kuvendit marrim një raport, ne kemi me raportu jo për një objekt po për dy objekte të cilat edhe ajo shkritoja që ka shkri barna, e tash që nuk mundet me shkri po i gjuajn nëpër fusha që është dëmi më I madh ekologjik, ky ka qen tmerri për mua vetem se na duhet me i marr krejt raportet se nuk guxojm me thën diqka që me von mundet me na ndjek dikush, ka dhe një raport të vlersusve të AME-së, ekspertave, policis, ne kemi pas problem edhe për ujë, na e kan ndal ujin në park të biznesit është shtu rreziku edhe i objekteve tjera. Është dasht me ardh në Drenas me marr ujë.

Pasi që nuk pati diskutime vërejtje tjera apo sugjerime Kryesuesi i Komunës Milaim Hajdari hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 22.02.2024.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim vendim për plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës së Drenasit lidhur me emërtimin kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- Pylltaria tash kalon në kuadër të nivelit qendror edhe ne duhet me i shkarku të gjithë ata me kopetenca

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për plotësim ndryshim të vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katër të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 25 vite të pronës komunale të Komunës së Drenasit Ministrisë së Punëve të Brendshme – Policisë së Kosovës, për ndërtimin e nënstacionit Policor në zonën kadastrale Komoran të Komunës së Drenasit.**

Hamit Haxhiu- për shfrytëzimin e pronave për 25 vite a kan përfundu të gjitha procedurat ligjore që me ja dhën policisë së Kosovës, Ministrisë së Punëve të Brendshme sepse kjo pronë u kan në shfrytëzim edhe më herët që MAPL mos të na kthej diqka rreth kësaj pike?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- një pronë që jepet me afat të caktun dhe nuk vazhdohet për shkak të performancës në kuvend ajo pronë nuk I kthehet komunës është në pronsi të komunës e kemi rrit edhe pronën si pronë u kan 10 ari tash është 20 ari është votu edhe në kuvend nuk ka asnjë shqetësim për këtë çështje sepse ka muaj që I kemi diskutu bashk me policinë e Kosovës dhe jemi në rregull me gjithëçka nuk ka ministria përveq me qenë mirënjohës që ne po Ia japim një pronë e cila është në interes të gjithë qytetarëve së pari zonës së Komoranit me fshatra po edhe e të gjithë qytetarëve të Kosovës sepse është në qendër të rrugës “Ibrahim Rugova” që e lidhë me rrugën “Arbër Xhaferi” dhe që e lidhë me katër shtetet që e kufizojn Kosovën dhe prej aty mund të lëvizin forcat e policisë së Kosovës për gjysmë ore në qdo kufi të mundshëm njësia e komunikacionit janë të vendosur në Fushë Kosovë në një rrugë qorre e cila e veshtirson lëvizjen e tyre dhe janë duke punu në kushte mizore në kantiniera. Ata kan ba kërkesë është në dorën e juaj ana tjetër nuk ka asnjë penges, askuj ma shumë se mu nuk I kushton si dëm politik ndërsa është interes I krejt qytetarëve edhe I komunës sonë edhe ashtu qytetarëtn në Komoran e kanë kërku në KKSB ti jepet mundësia edhe autoritetet financiare me hap nën deg të bankës edhe me ligj e kanë nëse është 3 kilometra larg stacionit të policisë. Kjo është një kërkesë e qytetarëve të Komoranit dhe të fshatrave përreth pastaj e policisë së Kosovës dhe nuk ka asnjë penges është pronë e jonau

Meqë nuk pati diskutime tjera vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Raporti përfundimtar për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2022.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim vendim për listen e rreziqeve.**

Meqë nuk pati diskutime tjera vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Raport për planin bazik.**


Nexhmedin Gruda- pas hartimit të plani zhvillimor komunal plani dhe rregullativ urbane e hartës zonale për Komunën e Drenasit është shtuar nevoja edhe për shqyrtimin e planit të vlersimit të rrezikshmëris për territorin e Komunës Drenasit, të dhënat në këtë plan të jenë të njëjta si në planin e lart shënuar sepse ka pasur ndryshime në ndërtimin e infrastrukturës përcjellëse, trotuar, ujësjellës, kanalizim, ndriqim e të tjera, një dokument i tillë ju dedikohet me propozim për miratimin e ti duke marrë parasysh faktin se sipas legjislacionit në fuqi kryetari i komunës obligohet që së bashu me mendimin e ti të njëjtin ta dorzoj në kuvendin komunal për shqyrtim dhe miratim. Jem në konsultim edhe me AME-në ata deri sa ti paraqesin mendimet e tyre pastaj e sjellin te ne edhe kompletohet plani, neve na duhet edhe për performancën komunale që të jet një plan i plotfuqishëm prandaj po kërkojm me vazhdu deri në hartimin e planit tjetër

Meqë nuk pati diskutime tjera vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Të Ndryshme.**

Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 10:30 min .

Procesmbajtëse



Indira Olluri Thaçi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milaim Hajdari



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Komuna/Opstina/Municipality Drenas (Glllogoc)
Zyra e Kryetarit



Nr. 01-400/01-18584 Dt. 16/04/2024

RAPORTI FINANCIAR JANAR - MARS 2024

PRILL 2024

1. Hyrje

Raporti financiar buxhetor, për periudhën Janar – Mars 2024, është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët: 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit, nr. 03/L – 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Raporti i përgatitur nga Kryetari i Komunës mbulon periudhë Janar – Mars të vitit fiskal 2024 dhe paraqet informatat që kanë të bëjnë me arkëtimin e të hyrave vetanake, shpenzimet dhe të dhënat mbi investimet kapitale.

1.1. Performanca e të hyrave

Grumbullimi i të hyrave buxhetore ka vazhduar gjatë këtij tremujori ku të hyrat direkte kanë shënuar një trend të ngjashëm krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Gjithsejt vlera e grumbulluar e të hyrave gjatë tremujorit të parë të këtij viti është 314,990.73€ ose 90.98% krahasuar me tremujorin e parë të vitit paraprak.

1.2. Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore për këtë periudhë kanë arritur vlerën prej: 4,055,521.04€ përgjatë tremujorit të parë të vitit 2024, apo 18.35 % të buxhetit të komunës për vitin 2024. Kjo vlerë e shpenzimeve kryesisht është nga ekzekutimi i shpenzimeve të pagave, shpenzimeve komunale, subvencioneve dhe investimeve kapitale.

Shpenzimet për paga dhe mëditje gjatë këtij tremujori, shënuan vlerën prej 3,233,572.97 €, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 29.31 % . Fatura e pagave gjatë periudhës raportuese, paraqet një rritje prej 2.18 % krahasuar me faturën e pagave në periudhën e njëjtë të vitit 2023 .

Shpenzimet në mallëra dhe shërbime- Duke marrë parasysh se buxheti Komunës së Denasit është alokuar në muajin shkurt të vitit 2024, atëherë gjatë këtij tremujori shpenzimet e kësaj kategorie kanë arrit vlerën prej: 282,927.57 € apo 10.43 % krahasuar me buxhetin total.

Shpenzime në komunal, shpenzimet për këtë kategori kanë shënuar rënie dhe kanë arrit vlerën prej: 40,957.61 € apo 11.75% krahasuar me buxhetin e vitit 2024. Kjo shumë korespondon me 7,400.42 € më pak sesa periudha e njëjtë e vitit paraprak.

Shpenzimet për subvencione dhe transfere, shënuan vlerën prej 53,091.06 € gjatë këtij tremujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 10.77 % krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar të kësaj kategorie. Subvencionet dhe transferet, gjatë periudhës raportuese paraqesin një rritje prej 33,611.56€ krahasuar me subvencionet dhe transferet në periudhën e njëjte të vitit 2023.

Shpenzimet kapitale janë realizuar me një normë të kënaqshme. Ato arritën vlerën prej: 444,971.83€, që është 5.93 % e buxhetit vjetor të vitit 2024. Krahasuar me shpenzimet në këtë kategori gjatë periudhës së njëjtë të vitit 2023, kemi më shumë shpenzim për 206,112.04 €. Vlera prej 77,741.35 nga kodi I projektit të Grantit të Performancës Komunale (92159) është shpenzuar për projektin Zgjerimi dhe ndertimi i sheshit “Fehmi e Xhevë Lladrovci” Drenas (49297).

Sa i përket **buxhetimit gjinor** mund të themi se përqindja e femrave në listën e të punësuarve arrin në 53.68% dhe buxheti i pagave i shpenzuar për këtë kategori ka shkuar në këtë përqindje të shpenzimit. Gjithashtu në periudhën Janar-Mars komuna ka ndarë dhe subvencione për organizata jo qeveritare dhe

individ ne vlere prej 53,091.06€. Gjithsejt ishin 13 perfitues ku prej tyre 8 perfitues ishin femra. Pjesa tjetër e subvencioneve është shpenzuar për shërbime të varrimit si dhe bashfinansim me OJQ për përkrahje të fermerëve.

Të hyrat vetanake për tremujorin e parë të vitit 2024 dhe krahasimi me vitet paraprake

Përshkrimi	2022	2023	2024	% me 2023
	në Euro			
1. GJITHSEJ TË HYRA	222,338.48	346,224.26	314,990.73	90.98
1.1. Të hyrat nga kodi 16301	41,494.79	54,264.00	22,455.13	41.38
Te hyrat ne pritje per shperndarje 50000			7.00	0
Taksa për certifikata (50013-50016)	10,176.00	13,054.50	11,871.00	90.93
Taksa per verifikimin e dokumenteve te ndryshme (50017)			422.29	0
Vert.Fotok.dokumentacionit (50018)	152	77	257.00	333.77
Kerkesat 50019	2,070.00	1,896.50	1,570.00	82.78
Gjobat e tjera 50107			55.79	0
Qeraja nga vendosja e objekteve tregtare 50407			7,868.00	0
Të Tjera 50413	-	-	0.00	0
Qeraja për Objektet Komunale 50408	29,096.79	24,377.00	0.00	0
Pranimet nga tarifat per vendime gjyqesore/permbarimore 50424			404.05	0
1.2.Të hyrat nga kodi 16601	140	2,810.00	4,337.50	154.36
Gjobat nga inspektorati 50104	140	2,810.00	4,337.50	154.36
1.3.Të hyrat nga kodi 17501	144,777.97	179,633.70	144,013.01	80.17
Tatimi në pronë 40110	118,036.97	150,713.70	111,944.01	74.28
Tax për regjistrimin e automjetit 50001	26,741.00	28,920.00	32,069.00	110.89
1.4. Të hyrat nga kodi 18001	500	3,220.00	1,171.84	36.39
Tax për parki.nga Sh.Publike 50008	500	3,220.00	596.50	18.52

Te hyrat nga viti I kaluar 61000			575.34	0
Tax për treg të hapur-kafsheve 50406	-	-	0.00	0
1.5.Të hyrat nga kodi 18161	2,625.00	1,347.52	0.00	0
Tax për leje ndertimi 50009	2,625.00	1,347.52	0.00	0
Te hyrat nga kodi 47001	0	0	0.00	0
Tax nga Pylltaria 50107	0	0	0.00	0
1.6.Te hyrat na kodi 48001	2,490.00	56,430.00	15,080.00	26.72
Licenca per aktivitete individuale dhe profesionale te lira (50201)	2,490.00	56,430.00	15,080.00	26.72
1.7.Të hyrat nga kodi 65005	9,875.50	19,457.50	23,342.00	119.96
Taksa per nderrim te pronarit te tokes 50011	5,802.00	14,983.00	17,918.50	119.59
Tax fletposeduese kopje planit. 50032	3,823.50	4,474.50	5,136.50	114.79
Matje gjeodezike 50504	250	-	287.00	0
1.8.Të hyrat nga kodi 66310	1,634.19	30,752.46	82,517.75	268.33
Taksa per parkim publik, kamping dhe rekreacion			21.00	0
Taks per leje ndertimi 50009	1,634.19	20,547.17	81,873.81	398.47
Shfrytzimi I pronës Komunale	-	2,004.32	0.00	0
Taks per legalizim te objektev 50026		2,460.10	545.94	22.19
Shfrytzimi I pronës Publike 50405		490.87	0.00	0
Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare 50407			24.00	0
Tax per ndrrim te tokës 50012	-	5,250.00	53.00	1.01
1.9.Të hyrat nga kodi 73100	7,295.00	8,713.00	11,648.00	133.69
Participimi shendetësi 50409	7,295.00	8,713.00	11,648.00	133.69
2.0. Te hyrat nga kodi 85001	300	-	12.50	0

Qiraja nga prona publike 50408	300	-	12.50	0
2.1. Te hyrat nga kodi 92210	7,658.00	8,919.50	10,413.00	116.74
Participimi Arsimi	7,658.00	8,919.50	10,413.00	116.74
2.1 Të Hyrat Indirekte	527,069.60	-		
Gjobat e gjykatave	6,470.00	-		
Gjobat e komunikacionit	105,248.30	-		
1.7.3 Donacion	-	401,013.41		

Shpenzimet për periudhën janar– mars 2024 dhe krahasimi me vitet paraprake

Përshkrimi	2022	2023	2024	Buxheti për vitin 2024	% e shpenzimit
Vitet	1	2	3	4	Me vitin 2023
2. GJITHSEJ SHPENZIMI	3,329,574.68	2,997,538.95	4,055,521.04	22,089,152.85	135.30
Shpenzimet operative	3,000,090.60	2,741,199.66	3,557,458.15	14,091,209.88	129.78
2.1.1 Paga dhe mëditje	2,386,518.64	2,451,727.15	3,233,572.97	11,031,326.85	131.89
2.1.2. Mallra dhe shërbime	209,584.83	241,114.48	282,927.57	2,711,434.03	117.34
2.1.3 Shpenzime komunale	74,503.05	48,358.03	40,957.61	348,449.00	84.70
2.2 Subvencione dhe transfere	28,222.90	17,479.50	53,091.06	493,000.00	303.73
2.3 Shpenzime kapitale	301,261.18	238,859.79	444,971.83	7,499,942.97	186.29
2.3.1 Rezervat	-			5,000.00	0.00

Subvencionet për periudhën janar-mars 2024 dhe krahasimi me vitet parapake

Përshkrimi	2022	2023	2024	% me 2023
	Shumat në Euro			
Zyra e kryetarit	1,500.00	1,200.00	0	0
DSHPE	14,364.42	11,529.50	15,515.00	134.57
D.Bujqësisë	0	0	30,000.00	0
D.Zhvillimit ekonomik	12,358.00	0	2,799.06	0
D.Kulturës, Rinisë dhe Sportit	0	1,600.00	2,277.00	142.31
Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	0	1,650.00	0.00	0
Drejtoria e Arsimit	0	1,500.00	2,500.00	166.67
Gjithsej	28,222.42	17,479.50	53,091.06	303.73

Shpenzimet në projekte kapitale për periudhën janar–mars 2024

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet deri me TM-1/2024	Mbetja	Progresi i TM-1/2024 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
18001	DSHPE				
53316	Sinjalizimi Horizontal dhe vertikal I rrugëve vendbanimeve	50,000.00	0	50,000.00	0
53330	Rreg.dhe rrethimi I varrezave Drenas dhe Komoran	23,656.00	0	23,656.00	0
53341	Zgjerimi i kamerave Drenas dhe Komoran	10,000.00	0	10,000.00	0
53346	Rregullimi I trotuarëve dhe parkingjeve Drenas dhe Komoran	10,000.00	0	10,000.00	0
53364	Rregullimi dhe zgjerimi I vendndaljeve dhe mbulimi I tyre	20,000.00	0	20,000.00	0

	GJITHSEJ	113,656.00	0	113,656.00	0
--	-----------------	-------------------	----------	-------------------	----------

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-1/2024	Mbetja	Progresi i TM-1/2024 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
18161	Drejtoria e Infrastruktures Publike				
48254	Rregullimi I shtratit të lumit Drenica dhe Verbica	25,000.00	0	25,000.00	0
48632	Asfaltimi I rrugës Gllanasellë, Godanc	100,000.00	0	100,000.00	0
48635	Asfaltimi I rrugës Paklek I vjeter, I Ri, Vasilevë	115,000.00	0	115,000.00	0
48638	Asfaltimi I rrugës Dobroshec, Çikatovë e vjeter	115,000.00	0	115,000.00	0
48643	Asfaltimi i rrugës në fshatrat Gradicë dhe Likoshan	80,000.00	0	80,000.00	0
48646	Asfaltimi rrugës Arllat Negroc Gjergjicë Bytyq	80,000.00	0	80,000.00	0
48648	Asfaltimi I rrugës Sankoc Fushticë	80,000.00	0	80,000.00	0
48653	Asfaltimi I rrugës Shtuticë,Verboc,Polluzhë	80,000.00	0	80,000.00	0
48656	Asfaltimi I rrugës Llapushnik,Poterk Vukoc	100,000.00	0	100,000.00	0
48658	Asfaltimi I rrugës Z.ulët,Lartë K. e ulet dhe e lartë	80,000.00	0	80,000.00	0
48661	Ndertimi I kapaciteteve të ujësjellësit Drenas	200,000.00	2,624.49	197,375.51	1.31
48682	Bashkfinancim projektesh me donator te jashtem	30,000.00	0	30,000.00	0
49297	Zgjerimi dhe ndertimi I sheshit Fehmi e Xheve Lladrovci Dr.	700,000.00	-	700,000.00	0
49299	Asfaltimi I rruges Llapushnik Berishë	300,000.00	100,000.00	200,000.00	33.33
51324	Asfaltimi I rrugëve Tersteniku I,II dhe Gllobar	80,000.00	0	80,000.00	0

51340	Asfaltimi I rruges Baicë Krajkovë Damanek Shtrubullojë	100,000.00	0	100,000.00	0
52309	Ndërtimi I Rrugës Bregut te Çiqavicës	5,000.00	0	5,000.00	0
52310	Ndërtimi I parkut dhe shtigjet për Këmbësor	256,804.00	0	256,804.00	0
53631	Ndërtimi I Kolektorve për grumbullimin e ujërave te zeza	400,000.00	0	400,000.00	0
53635	Rregullimi I Trotuarve dhe ndriqimit Publik	350,000.00	158,429.00	191,571.00	45.27
53645	Asfaltimi I rrugëve dhe Kubzimi Drenas I,II,III,IV	250,000.00	51,556.39	198,443.61	20.62
53652	Asfaltimi I rrugëve Komorani I,II,III,IV	100,000.00	0	100,000.00	0
53659	Ndërtimi I Tombinave dhe mureve mbrojtëse	80,000.00	0	80,000.00	0
53660	Ndërtimi zgjerimi dhe rikonstruimi I rrugëve të asfaltuara	560,000.00	0	560,000.00	0
53666	Ndërtimi, zgjerimi i rrjetit të kanalizimit	500,000.00	0	500,000.00	0
53670	Asfaltimi I rrugëve Abri dhe Tërdec	80,000.00	0	80,000.00	0
53672	Asfaltimi i rrugëve Nekoc Kizhnarekë	80,000.00	0	80,000.00	0
53674	Hapja e kanaleve Kulluese gjatë rrugëve Drenas Komoran	75,000.00	0	75,000.00	0
54100	Ndërtimi I rrugëve fushore ne Komunën e Drenasit	50,000.00	0	50,000.00	0
54104	Ndërtimi I rruges tranzit Drenas-Kroi I Mbretit	5,000.00	0	5,000.00	0
54108	Ndërtimi I digës për ujëmbledhës në fshatin Verboc	5,000.00	0	5,000.00	0
54266	Rregullimi I inf.ne parkun e pishave ne Komoran- Fushticë	5,000.00	0	5,000.00	0
92159	Granti për performance komunale	1,118,447.72	77,741.35	1,040,706.37	6.95
	GJITHSEJ	6,185,251.72	390,351.23	5,794,900.49	6.31

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-1/2024	Mbetja	Progresi i TM-1/2024 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
47001	Bujqësia				
	Grant I donatorve te brendshem	2,213.32	0	2,213.32	0
	Gjithsejt	2,213.32	0	2,213.32	0

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-1/2024	Mbetja	Progresi i TM-1/2024 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
66310	Urbanizmi				
53736	Vendosja e sistemit te adresave	5,000.00	0	5,000.00	0
53737	Gjelbrimi I hapsirave publike	43,000.00	0	43,000.00	0
54143	Ndërtimi I këndit të lojërave Drenas- Çikatovë e re banimi social	10,000.00	0	10,000.00	0
	GJITHSEJ	58,000.00	0	58,000.00	0

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-1/2024	Mbetja	Progresi i TM-1/2024 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
75501	Qendra për Punë Sociale				
54135	Veturë zyrtare për stafin e qendrës për Punë Sociale	60,000.00	0	60,000.00	0
54131	Ndërtimi shtëpisë për komunitete- Shërbime komunale për persona me aftësi të kufizuara	230,000.00	0	230,000.00	0
	GJITHSEJ	290,000.00	0	290,000.00	0

Përshkrimi	Buxheti	Mbetja	Progresi i
------------	---------	--------	------------

Kodi i projektit			Shpenzimet TM-1/2024		TM-1/2024 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
73100	QKMF				
53709	Rrethoja në QMF,AMF Komoran,Arllat, Nekoc, Terdec, Dobroshec	50,000.00	4,621.00	45,379.00	9.24
49181	Pajsje speciale mjeksore mbi 1000 €	30,822.00	0	30,822.00	0
54199	Renovimi I AMF Dobroshec, Sankoc dhe Komoran	30,000.00	0	30,000.00	0
54201	Veturë për vizita shtëpiake	40,000.00	0	40,000.00	0
54203	Blerja e gjeneratoreve për AMF Tërstenik, Gllanasellë, Arllat, Baicë, Nekoc	20,000.00	0	20,000.00	0
	GJITHSEJ	170,822.00	4,621.00	166,201.00	2.71

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-1/2024	Mbetja	Progresi i TM-1/2024 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
85001	Drejtoria e Kulturës				
54014	Fushat sportive dhe rekreacion Arllat, Llapushnik	20,000.00	0	20,000.00	0
54192	Renovimi I objekteve sportive stadioni sintetik Drenas- Komoran	20,000.00	0	20,000.00	0
89114	Ndërtimi I Stadiumit Faza e Dytë	270,000.00	49,999.60	220,000.40	18.82
	GJITHSEJ	310,000.00	49,999.60	260,000.40	16.13

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-1/2023	Mbetja	Progresi i TM-1/2023 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2

93000	Arsimi Fillor				
49194	Furnizimi I shkollave me pajisje te TIK-ut	70,000.00	0	70,000.00	0
53684	Dixhitalizimi I shkollave softwer, F,Lladrovci	60,000.00	0	60,000.00	0
53687	Kabineti në SHFMU D.Drenicës, SHMP F.Lladrovci , D.Fortesës , SH.Polluzha, M.S. Bytyqi	40,000.00	0	40,000.00	0
53689	Ndërtimi I Parkingjeve dhe Pllatove SH.Galica,G.Syla,7.Marsi	40,000.00	0	40,000.00	0
53691	Ndërtimi I fushave te jashtme dhe rrethojave G.Elshani, Xh.Lladrovci dhe D.Drenices	50,000.00	0	50,000.00	0
53696	Kendi per Lojra dhe rekreacion Z.Hajdini,QAP Ardhmeria ,R.Kiqina	40,000.00	0	40,000.00	0
54207	Ndertimi I aneksit te ri ne SHFMU Rilindja ne Dobroshec	30,000.00	0	30,000.00	0
54209	Instalimi I nxemjeve qendrore-riparimi I kulmit ne SHFMu Xh.Gashi- Plaku Komoran	15,000.00	0	15,000.00	0
54212	Nderimi I SHFMU Rasim Kiqina Drenas paralele e ndare ne Shtrubullove	25,000.00	0	25,000.00	0
	GJITHSEJ	370,000.00	0.00	370,000.00	0
611	GJITHSEJ KAPITALE	7,497,729.72	444,971.83	7,052,757.89	5.93

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci



[Handwritten signature in blue ink]



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 020/04-18430 dt. 16/04/2024

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), nenit 34.6 nënpika f të Statutit të Komunës së Gllgocit të aprovuar në vitin 2008, Vendimit të Kuvendit të Komunës 02 Nr.030/01-16028, të datës 29.03.2024, Memorandumit të Bashkëpunimit të datës 27.12.2023 për transferimin nga Komuna në Agjencinë Pyjore të stafit të Pylltarisë, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2024, të aprovoi këtë:

PROPOZIMVENDIM

Për formimin e komisionit për plotësim ndryshimin e nenit 85 të Statutit të Komunës së Drenasit

I

Më këtë propozim vendim formohet komisioni për plotësim ndryshimin e nenit 85 të Statutit të Komunës së Drenasit, të cilin Komision e përbejnë dy (2) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës të cilin e propozon Kryetari i Komunës, tre (3) anëtar nga Kuvendi i Komunës:

1. _____ - anëtar nga ekzekutivi;
2. _____ - anëtar nga ekzekutivi;
3. _____ - anëtar nga kuvendi;
4. _____ - anëtar nga kuvendi;
5. _____ - anëtar nga kuvendi;

II

Detyrë e komisionit është që të bëjë plotësim ndryshimin e nenit 85 të Statutit të Komunës së Drenasit, duke bërë riformulimin e emërimit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural si dhe të bëjë modifikimin e kompetencave të kësaj drejtorie, në përputhje me Memorandumin e Bashkëpunimit të datës 27.12.2023 për transferimin nga Komuna në Agjencinë Pyjore të stafit të Pylltarisë të Komunës së Drenasit.

III

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci



ARSYETIM

Me datë 27.12.2023 Komuna e Drenasit ka lidhur Memorandum të bashkëpunimit me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit lokal për transferimin nga Komuna e Drenasit në Agjencinë Pyjore të Kosovës të stafit të Pylltarisë, rojeve të pyllit, teknikeve të pylltarisë, përgjegjësive të njësive komunale etj bashkë me mjetet buxhetore përkatëse, automjetet dhe pajisjet e tjera si dhe mjetet tjera përkatëse funksionale që lidhen me përgjegjësitë dhe detyrat e ndryshme pyjore.

Andaj duke marrë parasysh Memorandumin e lartcekur dhe faktin se stafi i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural tashmë ka kaluar në Agjencinë Pyjore të Kosovës, përmes këtij dokumenti propozohet që në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda kompetencave të veta Kuvendi i Komunës të aprovoj Propozimin Vendimin për formimin e komisionit për ndryshimin e nenit 85 të Statutit të Komunës së Drenasit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
ZYRA E KRYETARIT



01 Nr.400-18566 dt. 16/04 2024

Në vështrim të nenit 58 par.1 pika h ,si dhe nenit 40 pika 40.2 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 4 qershor 2008), nenit 72 të Statutit të Komunës së Glllogocit, komfor udhëzimit administrative (Shëndetësi),Nr 04 /2020, kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë të datës 24/01/2024, Statutit të QKMF-së të aprovuar nga këshilli drejtues datë 14.03.2024 me nr protokoli 06-400/01-13306, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt më datë _____ vitit 2024, të aprovoi këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për aprovimin Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr Hafir Shala” për Komunën e Glllogocit

- I.** Me këtë Propozim Vendim behët miratimi i draft **Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare** nr 06-400/01-13306 për Komunën e Glllogocit;
- II.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Qendra e Kryesore e Mjekësisë Familjare në Komunën e Glllogocit.
- III.** Ky Propozim Vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës, dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

A r s y e t i m

Draft **Statuti i Qendrës Kryesore i Mjekësisë Familjare** është dokument i hartuar në bazë të udhëzimit administrative (Shëndetësi) **Nr 04 /2020**, i cili ka kaluar në procedurat e konsultimit publik ashtu siç është e paraparë me ligj, atëherë kërkojmë nga kuvendi i komunës që të bëjë miratimin e draft **Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare**, nr **06-400/01-13306** për Komunën e Glllogocit. Me këtë Statut rregullohen: dispozitat e përgjithshme, emërtimi dhe selia, veprimtaria e QKMF-së, statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e institucionit, udhëheqja dhe trupat e institucionit, zhvillimi i vazhdueshëm institucional, mbikëqyrja e QKMF-së, aktet e përgjithshme të QKMF, pronësia dhe financimi, transparenca në punë, konfidenca profesionale dhe afariste, organizimi sindikal, mbikëqyrja e brendshme dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së kujdesit shëndetësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare.



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GILLOGOC			
GILLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	46/037	2024	
Nj. Org.	Númer	Shtojca	Vlera
06	-100101	-13006	

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Gillogocit

Opština Gillogovac-Municipality of Gillogoc

STATUTI

I

QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE "DR. HAFIR SHALA" NË GILLOGOC

STATUTE

of the

MAIN FAMILY MEDICINE CENTER "DR. HAFIR SHALA" IN GILLOGOC

STATUT

GLAVNOG CENTRA PORODICNE MEDICINE "DR.HAFIR SHALA" U GILLOGOVAC

GILLOGOC, 2024



GLAVNOG CENTRA PORODIČNE MEDICINE

Kompetencat e Kuvendit Komunal,	Competencies of the Municipal Assembly,	Nadležnosti Skupštine Opštine,
<p>Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 12, nenit 45 paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi(Gazeta Zyrtare nr 13, 07.05.2013), nenit 12 paragrafi 12.1 dhe nenit 68, paragrafi 68.4. të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale Nr.28/2008 të Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe nenit Paragrafi të Statutit të komunë së Glllogocit, Kuvendi i komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur më, miraton</p> <p>Në mbështetje të nenit 45, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125,</p> <p>Miraton:</p>	<p>In accordance with Article 18, paragraph 12, Article 45, paragraphs 1 and 2 of Law no. 04 / L-125 for Health (Official Gazette No. 13, from 07.05.2013.), On the basis of Article 12, paragraph 12.1 and article 68 paragraph 68.4 of the Law on Local Self-Government No.28 / 2008 from Official Gazette of Republic of Kosovo, as well as Article....., paragraph..... of the Statute of Glllogoc municipality no....., the Assembly Glllogoc at its meeting held on approves Pursuant to Article 45, paragraph 1 and 2 of Law No. 04/L-125on Health, Adopts the following:</p>	<p>U skladu sa članom 18. stav 12, članom 45 stav 1 i 2, Zakona br . 04/L-125 za Zdravstvo (Službeni list br.13. dana 07.05.2013.), na osnovu člana 12 stav 12.1 I člana 68 stav 68.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.28/2008 Službeni List Republike Kosova, kao i člana stav Statuta opštine Glllogoc Nr., Skupština Glllogoc na sednici održanoj dana....., usvaja:</p> <p>Na osnovu člana 45. stavke 1. i 2. Zakona o zdravlju br. 04/L-125,</p> <p>Usvaja:</p>
STATUTIN	STATUTE OF THE	STATUTI

Kompetencat e Kuvendit Komunal,	Competencies of the Municipal Assembly,	Nadležnosti Skupštine Opštine,
<p>Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 12, neni 45 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi(Gazeta Zyrtare nr 13, 07.05.2013), neni 12 paragrafi 12.1 dhe neni 68, paragrafi 68.4. të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale Nr.28/2008 të Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe neni Paragrafi të Statutit të komunë së Glllogocit, të Kuvendi i komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur më, miraton</p> <p>Në mbështetje të nenit 45, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125,</p> <p>Miraton:</p> <p style="text-align: center;">STATUTIN</p> <p style="text-align: center;">E QENDRËS KRYESORE TË MIJEKËSISË FAMILJARE</p> <p style="text-align: center;">Neni 1</p> <p style="text-align: center;">I - Dispozitat e përgjithshme</p>	<p>In accordance with Article 18, paragraph 12, Article 45, paragraphs 1 and 2 of Law no. 04 / L-125 for Health (Official Gazette No. 13, from 07.05.2013.), On the basis of Article 12, paragraph 12.1 and article 68 paragraph 68.4 of the Law on Local Self-Government No.28 / 2008 from Official Gazette of Republic of Kosovo, as well as Article....., paragraph..... of the Statute of Glllogoc municipality no....., the Assembly Glllogoc at its meeting held on, approves</p> <p>Pursuant to Article 45, paragraph 1 and 2 of Law No. 04/L-125 on Health,</p> <p>Adopts the following:</p> <p style="text-align: center;">STATUTE</p> <p style="text-align: center;">OF THE</p> <p style="text-align: center;">MAIN FAMILY MEDICINE CENTER</p> <p style="text-align: center;">Article 1</p> <p style="text-align: center;">I – General provisions</p>	<p>U skladu sa članom 18. stav 12. članom 45 stav 1 i 2, Zakona br . 04/L-125 za Zdravstvo (Službeni list br.13. dana 07.05.2013.), na osnovu člana 12 stav 12.1 I člana 68 stav 68.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.28/2008 Službeni List Republike Kosova, kao i člana stav Statuta opštine Glllogoc Nr., Skupština Glllogoc na sednici održanoj dana....., usvaja:</p> <p>Na osnovu člana 45, stavke 1. i 2. Zakona o zdravlju br. 04/L-125,</p> <p>Usvaja:</p> <p style="text-align: center;">STATUT</p> <p style="text-align: center;">GLAVNOG CENTRA PORODIČNE</p> <p style="text-align: center;">MEDICINE</p> <p style="text-align: center;">Član 1</p> <p style="text-align: center;">I - Opšte odredbe</p>

<p>Me këtë Statut rregullohen: dispozitat e përgjithshme, emërtimi dhe selia, veprimtaria e QKMF-së, statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e institucionit, udhëheqja dhe trupat e institucionit, zhvillimi i vazhdueshëm institucional, mbikëqyrja e QKMF-së, aktet e përgjithshme të QKMF, pronësia dhe financimi, transparenca në punë, konfidenca profesionale dhe afariste, organizimi sindikal, mbikëqyrja e brendshme dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së kujdesit shëndetësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare QKMF, Dr.Hafir Shala' Gillogoc</p>	<p>This Statute regulates: general provisions, designation and headquarter, activity of MFMC, legal status, representation and presentation, structure of the institution, leadership and bodies of the institution, continuous institutional development, supervision of MFMC, general acts of MFMC, ownership and financing, transparency at work, professional and business confidence, trade union organization, internal supervision and transitional and final provisions relating to the exercise of healthcare activity in the Main Family Medicine Center: MFMC, Dr.Hafir Shala' Gillogoc.</p>	<p>Ovim Statutom se ureduju: opšte odredbe, naziv i sedište, delovanje GCPM-a, pravni status, zastupanje i prikazivanje, struktura institucije, rukovodstvo i tela institucije, kontinuirani institucionalni razvoji, nadzor GCPM-a, opšti akti GCPM-a, vlasništvo i finansiranje, transparentnost u radu, profesionalna i poslovna poverljivost, sindikalno organizovanje, unutrašnji nadzor i prelazne i konačne odredbe u vezi sa sprovođenjem delatnosti primarne nege u Glavnom centru porodične medicine GCPM ,Dr.Hafir Shala' Gillogoc</p>
<p style="text-align: center;">Neni 2 Statusi i QKMF</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 MFMC Status</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Status GCPM</p>
<p>1.QKMF ka statusin e personit juridik publik, me cilësi të autoritetit punëdhënës, ku organizohet,</p>	<p>1.The MFMC has the status of a public legal entity, having the quality of the employing</p>	<p>1.GCPM ima status javnog pravnog lica, u svojstvu autoriteta poslodavca, gde se</p>

<p>offohet dhe zbatohet Kuqdesi Parësor Shëndetësor Publik (KPPSh)</p> <p>2. Themelues i QKMF është Kuvendi Komunal Gillogoc</p> <p>3. QKMF në Komunën e Gillogocit ka filluar punën në vitin 1959</p>	<p>authority, where the Public Primary Healthcare is organized, provided and implemented (PHC).</p> <p>2. The founder of the MFMC Dr. Hafir Shala' is the Municipal Assembly of Gillogoc</p> <p>3. The MFMC, Dr. Hafir Shala' Gillogoc has started the work in 1959 (the year).</p>	<p>organizuje, pruža i primenjuje Javna Primarna Zdravstvena nega (PZN).</p> <p>2. Osnivač GCPM je Skupština opštine Gillogoc</p> <p>3. GCPM u Opštine Gillogoc je počeo sa radom 1959 godine.</p>
<p>II - Emërtimi dhe Selia</p> <p>Neni 3</p> <p>Emërtimi</p> <p>1. Emri i institucionit është: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Dr. Hafir Shala' Gillogoc</p> <p>2. Shenja njohëse e këtij institucioni është unike për të gjitha QKMF në Republikën e Kosovës dhe aprovohet nga Kuvendi Komunal, në bazë të procedurave ligjore.</p>	<p>II - Designation and Headquarter</p> <p>Article 3</p> <p>Designation</p> <p>1. The name of the institution is: Main Family Medicine Center, Dr. Hafir Shala' in Gillogoc</p> <p>2. The recognition mark of this institution is unique for all MFMC in the Republic of Kosovo and is approved by the Municipal Assembly, on the basis of legal procedures.</p>	<p>II – Naziv i Sediste</p> <p>Član 3</p> <p>Naziv</p> <p>1. Naziv institucije je: Glavni Centar Porođične Medicine, Dr. Hafir Shala' Gillogoc</p> <p>2. Identifikacioni znak ove ustanove je jedinstven za sve GCPM u Republici Kosovo i usvaja se od Skupštine opštine, na osnovu pravnih procedura.</p>

<p>3. Emërtimi i QKMF, QMF dhe AMF duhet të jetë i mbishkruar qartë në hyrje të institucionit shëndetësor përkatës të KPSh.</p>	<p>3. The name of MFMC, FMC and FMA should be clearly indicated at the entrance of the respective health institution of PHC.</p>	<p>3. Naziv GCPM-a, CPM-a i APM-a mora biti jasno naddisan na ulazu dotične zdravstvene ustanove PZN-a.</p>
<p>4. Për ndryshimin e selisë së QKMF vendos themeluesi, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Shëndetësisë.</p>	<p>4. Changing of the MFMC headquarter shall be decided by the founder, upon obtaining the consent of the Ministry of Health.</p>	<p>4. Za promenu sedišta GCPM-a odlučuje osnivač, nakon dobijanja pristanka od Ministarstva zdravstva.</p>
<p>Neni 4 Selia</p> <p>Selia e QKMF në Komunën Gillogoc gjendet në Rrugen “Xhevat Demaku” Gillogoc</p>	<p>Article 4 Headquarter</p> <p>The MFMC headquarters in Municipality Gillogoc is located at MFMC was in street “Xhevat Demaku” Gillogoc</p>	<p>Član 4 Sedište</p> <p>Sedište GCPM Opštine Gillogoc se nalazi u ulicu “Xhevat Demaku”</p>
<p>Neni 5 Vula</p> <p>1. QKMF posedon vulën e saj që në qarkullimin juridik paraqitet si Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare.</p>	<p>Article 5 Stamp</p> <p>1. MFMC possesses its stamp, which in the legal circulation is presented as the Main Family Medicine Center.</p>	<p>Član 5 Pečat</p> <p>1. GCPM ima svoj pečat koji se u pravnom protoku predstavlja kao Glavni centar porodične medicine.</p>

